

STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

STATUTI I NDRYSHUAR I SHOQERISE  
UNITSYSTEM SHPK.

Sot me, 06.12.2021 te nenshkruarit:

- **Z. Gjergji Robo**, shtetas Shqiptar, lindur me 18.05.1984, mbajtes i leternjoftimit me numer personal I405518067I;
- **Smartwork Shpk.** nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara, e organizuar dhe ekzistuese ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise, regjistruar prane Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit, me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS): L71928020R dhe seli ne adresen: Rruga "Jordan Misja", Kompleksi "USLUGA", Kati 2, Tirane, Shqiperi perfaqesuar rregullisht nga administrator z. Andrea Ruscica.
- **TeamSystem S.p.A.** nje shoqeri aksionare, e organizuar dhe ne ekzistuese ne perputhje me legjislacionin Italian, regjistruar prane Regjistrin Tregtar ne Pesaro dhe Urbino nen nr. 01035310414, dhe seli ne adresen Via Sandro Pertini 88, Pesaro (Itali), perfaqesuar nga Tommaso Giovanni Cohen autorizuar rregullisht.

Ortaket e nenshkruar si me siper, me vullnet te plote dhe te lire, nenshkruajne si ne kete akt Statutin e Rishikuar te Unitsystem SHPK., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara e themeluar dhe qe qeveriset ne perputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ne Republikën e Shqiperise me nr. NUIS M12402020H. Ky Statut i Rishikuar zevendeson dhe shfuqizon statutin e Unitsystem SHPK 01 dhjetor 2021 dhe do te mbizoteroje mbi çdo parashikim i Aktit te Themelimit i cili mund te jete ne kundërshtim me kete Statut.

Neni 1


Emri

Shoqeria do te quhet Unitsystem Shpk. (ketu e ne vijim referuar si "**Shoqeria**").

Neni 2

Forma ligjore

Unitsystem Shpk., eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara, e cila eshte organizuar dhe ushtron aktivitetin e saj tregtar ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe ne vecanti me parashikimet e ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar ("Ligji per tregtaret dhe shoqerite tregtare") dhe ne perputhje me kete Statut.



Handwritten signatures and initials in blue ink, including a large signature that appears to read "Viktorija Jom" and other illegible marks.

## STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

### Neni 3

#### Selia

- 3.1 Selia e Shoqerise do te jete ne adresen:  
Rruga "Jordan Misja", Kompleksi "USLUGA", Kati 2, Tirane, Shqiperi.
- 3.2 Shoqeria permes Administratorit te saj mund te themeloje dhe/ose te mbylle filiale, dege, agjenci dhe/ose zyra perfaqesimi, qofte brenda por edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

### Neni 4

#### Kohezgjatja

- 4.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje kohe te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj prane Regjistrimit Tregtar.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqerise do te percaktohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhe me parashikimet e ketij dokumenti dhe legjislacionit ne fuqi.

### Neni 5

#### Objekti i aktivitetit


- 5.1 Shoqeria do te kete objekt aktiviteti tregtar si vijon:
- Projektimi, realizimi, menaxhimi dhe kontrolli i sistemeve informatike dhe te programeve aplikative, si dhe ushtrimin e aktivitetit informatik dhe telematik te kryer ne favor te paleve te treta, perpunimin e te dhenave per pale te treta, realizimin dhe shitjen e produkteve editorial.
  - Aktivitet te tregtimit, si me pakice ashtu edhe me shumice, me korrespondence dhe me rruge telematike, te produkteve dhe sherbimeve per shoqeri tregtare, per profesioniste dhe persona private, per automatizimin e zyres dhe, ne pergjithesi per informatizimin e te dhenave, si dhe te aparaturave, mobilieve dhe pajisjeve per zyra.
- 5.2 Ne pergjithesi, Shoqeria mund te ushtroje çfaredo aktiviteti te dobishem apo te nevojshem te lejuar nga ligji, ne menyre qe te ushtroje aktivitetin e saj tregtar.

### Neni 6

#### Kapitali

- 6.1 Kapitali i Shoqerise eshte 10 000 Leke.
- 6.2 Kapitali i nenshkruar i Shoqerise perbehet nga 3 kuota te paguara plotesisht dhe te mbajtura nga ortakët siç parashikohet ne nenin 7 si me poshte.

### Neni 7

  
Viktoro Spina  
Spina

## STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

### Ortakët

Ortakët e Shoqërisë dhe pjesëmarrja e tyre në kuota është si vijon:

Ortakët	Kuotat		
	Nr.	Vlera	Përqindja
Z. Gjergji Robo	1	2900 Leke	29%
Smartwork Shpk	1	6900 Leke	69%
TeamSystem S.p.A.	1	200 Leke	2%
<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>10,000 Leke</b>	<b>100%</b>

Transferimi i kuotave është subjekt i kufizimeve të parashikuara nga ky Statut dhe Marrëveshja për të drejtën e blerjes datë 06 dhjetor 2021 lidhur mes, Smartwork Shpk, Gjergji Robo dhe TeamSystem S.p.A. ("Marrëveshja për të drejtën e blerjes").

### Neni 8


#### Zmadhimi dhe Zvogelimi i kapitalit

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.2 Në rastin e zmadhimit të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen e kapitalit në proporcion me kuotën që mbajnë në kapitalin e Shoqërisë. Në rast se ndonjë prej ortakëve heq dorë nga e drejta e tij e nënshkrimit, pjesa e kapitalit e pa nënshkruar mund të nënshkruhet nga ortaku/et e mbetur në proporcion me kuotën që mbajnë në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.3 Shoqëria mund të zvogelojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogelohet nën minimumin ligjor.
- 8.4 Zvogelimi i kapitalit të Shoqërisë do të ndikojë tek të gjithë ortakët në proporcion me kuotën që mbajnë në kapitalin e Shoqërisë.

### Neni 9

#### Transferimi i kuotave

- 9.1 Kuotat transferohen pa kufizime : (i) midis ortakëve ; (ii) midis ortakëve dhe grupit të tyre të shoqërive; dhe/ose (iii) ndaj pasardhësve të ortakëve.
- 9.2 E drejta e parablerjes




Handwritten signatures and initials in blue ink, including the name "V. Blou, Spm" and a signature below it.

## STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

Ne rast se ndonje prej ortakeve deshiron te shese, transferoje apo te disponoje ndryshe kuoten e tij apo nje pjese te saj (kjo pale do te quhet "Shitesi") ndaj nje pale te trete te pa permendur ne nenin 9.1 si me sipër, ortaku/et e tjere ("Ofertuesit") do te kene te drejten e parablerjes ndaj kesaj kuote ose pjese te kuotes ("Kuota e Ofruar") dhe do te aplikohet sa me poshte :

- 9.2.1 Shitesi do t'i dergoje Ofertuesit/esve nje njoftim me shkrim ne lidhje me deshiren apo synimin e tij per te shitur kuoten e tij apo nje pjese te saj ndaj nje pale te trete. Ky njoftim do tu jepet me shkrim Ofertuesit/esve ne perputhje me parashikimet e bera ne kete Statut. Ky njoftim ("Njoftimi per Shitje") do te percaktoje:
- (i) kuoten ne pronesi te Shitesit;
  - (ii) pjesen e kuotes e cila perben Kuoten e Ofruar, çmimin dhe kushtet dhe afatet e shitjes se Kuotes se Ofruar;
  - (iii) emrin e bleresit te propozuar;
  - (iv) duke i bashkangjitur nje kopje te letres se interesimit te nenshkruar ("LOI") ose marreveshjes ndermjet Shitesit dhe bleresit te propozuar.
- 9.2.2 Çdo Ofertues, brenda nje periudhe prej tridhjetë (30) ditesh pas dates kur do te konsiderohet se eshte derguar Njoftimi per Shitje, mund ti jape Shitesit nje njoftim me shkrim ne perputhje me parashikimet e ketij Statuti. Ky njoftim ("Njoftimi i Blerjes") do te parashikojë ose se ky Ofertues eshte i gatshem te bleje Kuoten e Ofruar apo se ai/ajo nuk eshte i gatshem te bleje Kuoten e Ofruar. Ne rast se nje Ofertues nuk dergon Njoftimin e Blerjes ai/ajo do te konsiderohet se ka refuzuar blerjen e Kuotes se Ofruar.
- 9.2.3 Pasi Shitesi ka marre te gjithë Njoftimet e Blerjes potenciale, apo pasi kane kaluar tridhjetë (30) dite nga data e Njoftimit per Shitje, cilado vjen me heret, Shitesi do te jete i detyruar te shese Kuoten tek Ofertuesi/esit te cilet kane treguar ne Njoftimin e Blerjes se kane deshire te blejne Kuoten e Ofruar ("Bleresit") me ate çmim ose kushte siç parashikohet ne Njoftimin per Shitje.
- 9.2.4 Ne rast se me shume se nje Ofertues ka dhene nje Njoftim Blerjeje tek Shitesi duke treguar vullnetin e tij per te blere Kuoten e Ofruar, atehere, Bleresit do te blejne Kuoten e Ofruar ne ato proporcione qe do te bien dakord, ose, ne mungese te marreveshjes, proporcionalisht me kuoten e mbajtur nga çdo Bleres e cila llogaritet pa iu referuar kuotes se Shitesit.
- 9.2.5 Ne rast se Ofertuesi/et per shkak te parashikimeve ne kete dokument, nuk blejne Kuoten e Ofruar atehere Shitesi do te jete i lire te shese Kuoten e Ofruar bleresit te propozuar siç parashikohet ne Njoftimin per Shitje por vetem per nje çmim te barabarte apo me te larte se çmimi qe parashikohet ne Njoftimin per Shitje si edhe me te njejtat kushte te percaktuara ne Njoftimin per Shitje apo ne kushte te cilat jane me te favorshme per Shitesin se ato te percaktuara ne Njoftimin per Shitje. Nese, brenda njeqind e pesedhjetë ditesh (150) nga data e perfundimit te afatit prej tridhjetë (30) ditesh per Ofertuesin/it qe te ushtronin te drejtat e tyre si me sipër, Shitesi nuk ka perfunduar shitjen e Kuotes se Ofruar ndaj bleresit te propozuar siç percaktohet ne Njoftimin per Shitje, atehere te drejtat e Ofertuesit/esve do te rilindin ne lidhje me Kuoten e Ofruar dhe nese Shitesi deshiron te shese ndonje prej kuotave te tij/saj ai do te njoftoje sipas nenit 9.2 te ketij Neni 9 per secilen here.



Viktorie Son  
Son

## STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

9.2.6 Çdo oferte per ti shitur kuotat nje pale te trete duhet te perfshije kushtin qe pala e trete te pranoje te behet pale e ketij Statuti, Marreveshjes per te drejten e blerjes dhe/ose te gjithe marreveshjeve te ortakeve ne fuqi ne ate moment, perpara blerjes se kuotave.

### 9.3 Kufizimet e transferimit

Asnje ortak nuk do te shese, caktoje, transferoje, disponoje, dhuroje, te vendos barre te çfaredolloj (bashkerisht "*Disponim*") ndonje prej kuotave te tij/saj per nje periudhe prej tre (3) vjetesh duke nisur nga data 06 dhjetor 2021 . Çdo Disponim i kuotave i bere pergjate ketyre periudhave do te konsiderohet nul dhe i pavlefshem dhe nuk do te sjelle asnje efekt per Shoqerine.

## Neni 10




### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

- 10.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve perfaqeson te gjithe ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe kete dokument, jane te detyrueshme per te gjithe ortaket.
- 10.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese *inter alia* per vendime per çeshtjet e meposhtme :
- i. percakton politikat tregtare te Shoqerise;
  - ii. miraton ndryshimet e statutit;
  - iii. emeron dhe shkarkon administratoret, ekspertet kontabel te miratuar dhe likuiduesit si edhe percakton shperblimin e tyre;
  - iv. zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - v. transferimin e kuotave;
  - vi. shperndarjen e dividendit;
  - vii. ri-organizimin dhe/ose prishjen e Shoqerise; dhe
  - viii. çeshtje te tjera te percaktuara nga legjislacioni i aplikueshem dhe nga ky Statut.

## Neni 11

### Pjesemarrja ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, kuorumi dhe vendimet

- 11.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme personalisht apo permes nje perfaqesuesi me prokure dhe te votoje ne proporcion me kuoten qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise.
- 11.2 Ne rast te perfaqesimit me prokure, prokura mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e vlefshme per thirrje te tjera me te njejtin rend dite.

  
  
Viktorino Span  


## STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

- 11.3 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret te pakten 1 (nje) here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e pasqyrave financiare, raportin e Administratorit/eve dhe raportin e ekspertit kontabel te miratuar (nese emerohet). Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret sa here kjo te jete e nevojshme nga legjislacioni i aplikueshem apo Statuti i Shoqerise, si edhe sa here qe kjo mbledhje te jete e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise.
- 11.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet nga Administratori/et apo nga keta te fundit kur kerkohet me shkrim nga ortaku/et qe zoterojne te pakten 2% (dy perqind) te vleres se kapitalit te Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te thirret permes postes se regjistruar apo postes elektronike me konfirmim marrjeje e cila duhet tu dergohet ortakeve prane adresave te banimit te deklaruar ne Shoqeri. Njoftimi duhet te permbaje daten, kohen, vendin dhe rendin e dites.
- 11.5 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te mblidhet ne seline e Shoqerise apo ne çdo vend tjetër, qofte brenda Republikës së Shqipërisë apo jashtë.
- 11.6 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te mbahet permes audio apo video konferences, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te identifikohen nga kryetari dhe tu jepet mundësia te ndjekin ne menyre aktive diskutimet si edhe te marrin pjese ne to. Pas verifikimit te ketyre kerkesave te cilat do te parashikohen ne proces verbalin e mbledhjes, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te konsiderohet si e mbajtur ne vendin ku jane prezent kryetari dhe sekretari i mbledhjes se bashku.
- 11.7 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te konsiderohet si e thirrur dhe mbledhur rregullisht edhe nese te gjithë formalitetet ne lidhje me thirrjen nuk jane zbatuar, me kusht qe, te gjithë ortaket te jene prezent apo te perfaqesuar dhe te gjithë ortaket/perfaqesuesit bien dakord te vijojne me mbledhjen pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.
- 11.8 Perveçse kur parashikohet ndryshe nga ky Statut ne rastin e vendimmarrjes kur kerkohet nje shumice e thjeshte, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë perqind) te kuotave me te drejte vote. Per çeshtje sipas nenit 87 paragrafi 1 i Ligjit per shoqerite tregtare, te cilat kerkojne nje shumice te cilesuar, perveç atyre te listuara ne pikat (ii), (iv), (v) dhe (vii) te nenit 10.2 me siper, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme nese ortaket te cilet zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave marrin pjese ne votim. Ne kete rast, vendimet do te merren me nje vote shumice prej te pakten ¾ te ortakeve qe marrin pjese ne mbledhje.
- Per çeshtjet e listuara ne nen paragrafet (ii), (iv), (v) dhe (vii) te nenit 10.2, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme ne çdo mbledhje apo mbledhje te shtyre vetem permes votimit unanim te 100% te kuotave me te drejte vote te Shoqerise. Per sa i perket emerimit apo shkarkimit te administratoreve, ortaket do te votojne per te emeruar te pakten nje administrator te propozuar nga TeamSystem S.p.A. Shkarkimi i administratorit te propozuar nga TeamSystem S.p.A. nuk mund te behet pa votimin aprovues (pro) te TeamSystem S.p.A.
- 11.9 Ne çdo rast, ne mungese te kuorumit, ne kete mbledhje nuk do te kryhen diskutime/merren vendime dhe Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret perseri jo me vonë se 30 dite ne

Viktoria fm  
fm

## STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

te njejtin vend dhe ne te njejtin menyre siç ish percaktuar fillimisht te mblidhej mbledhja e meparshme.

- 11.10 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve kryesohet nga kryetari i emeruar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve i cili emerohet nje sekretar per te mbajtur proces verbalin.

### Neni 12


#### Administrimi

- 12.1 Shoqeria do te administrohet nga te pakten dy administratore. Nje nga administratoret do te propozohet nga TeamSystem S.p.A.
- 12.2 Administratoret do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve dhe mund te shkarkohet ne çdo kohe nga kjo detyre ne te njejtin menyre.
- 12.3 Administratoret do te jete person fizik pa ndonje pa ndonje kufizim ne lidhje me shtetesine. Kohezgjatja e mandatit te Administratoreve do te vendoset ne momentin e emerimit, por ne çdo rast nuk mund te tejkalohet afatin 5 (pese) vjeçar. Pavaresisht ketij kufizimi, kohezgjatja e mandatit mund te riperterihet me ane te vendimit te Asamblese se Pergjithshme

### Neni 13

#### Kompetencat e Administratorit/eve

- 13.1 Administratoret eshte pergjegjes per administrimin e Shoqerise dhe perfaqeson Shoqerine ndaj paleve te treta, ne perputhje me parashikimet e ketij Statuti dhe legjislacionit te aplikueshem.
- 13.2 Kompetencat dhe detyrat e Administratorit/eve ne lidhje me administrimin dhe mbikeqyrjen e aktivitetit tregtar te Shoqerise do te perfshijne por pa u limituar si me poshte:
- a) zbatimi/implementimi i politikave tregtare te Shoqerise dhe vendimeve te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
  - b) zbatimin e legjislacionit dhe standardeve te kontabilitetit nga Shoqeria;
  - c) ndermarrjen e gjithë veprimeve te nevojshme ne lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise;
  - d) te sigurohet se Shoqeria mban ne menyre te rregullt dokumentacionin financiar dhe te kontabilitetit;
  - e) perfaqesimi i Shoqerise ndaj paleve te treta siç percaktohet ne aktin e emerimit;
  - f) te kryej te gjithë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine siç kerkohet nga legjislacioni ne fuqi;
  - g) te punesoje dhe shkarkoje nga detyra punemarres;
  - h) te kryej detyra te tjera siç parashikohet nga ligji dhe ky Statut.
- 13.3 Administratoret mund te ushtroje te gjithë kompetencat dhe veprimet, perveç atyre, te cilat sipas ligjit dhe ketij Statuti i rezervohen Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve apo kufizohen nga ky Statut apo legjislacioni i aplikueshem. Administratoret mund te ushtrojne vecmas kompetencat e

  
Viktorie Jm  
Jm

## STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

listuara me siper por, ne çdo rast, pas konsultimeve me njeri tjetrin. Perjashtimisht, veprimet e listuara sipas pikes (g) te paragrafit 13.2 si me siper, mund te ushtrohen me menyre te vlefshme vetem pas nenshkrimit te perbashket te Administratoreve ku te pakten njeri do te jete nenshkrimi i Administratorit te propozuar nga TeamSystem S.p.A.

- 13.4 Administratori/et mund te delegoje nje pjese apo te gjithe kompetencat ndaj personave te tjere.
- 13.5 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton, permes nje vendimi, kufizimet e kompetencave, objektin e kompetencave te çdo administratori dhe, nese eshte e nevojshme, procedurat per mbledhjen e administratoreve.

### Neni 14

#### Eksperti Kontabel i Miratuar

Nese kerkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, kontrolli i pasqyrave financiare dhe te dhenave kontabel te Shoqerise do t'i besohet 1 (nje) ose me shume eksperteve kontabel te miratuar.

### Neni 15

#### Viti financiar dhe Pasqyrat financiare

- 15.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.
- 15.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise prane Regjistrimit Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor 2021.
- 15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit/eve dhe ekspertit kontabel te miratuar, nese ka nje te tille, miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ne perputhje me Ligjin per shoqerite tregtare.

### Neni 16

#### Prishja dhe Likuidimi i Shoqerise

- 16.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te vendose per prishjen e Shoqerise permes nje vendimi te marre ne perputhje me kuorumin e vlefshem sipas ketij Statuti. Prishja e Shoqerise do te pasohet nga procedura e likuidimit.
- 16.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te emeruje 1 (nje) ose me shume likuidues dhe percakton tagrat e tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 16.3 Shoqeria vazhdon te ekzistojte si person juridik vetem per nevoja te likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi. Gjate likuidimit togfjaleshi "ne likuidim e siper" duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.

Viktorie Jon  
Jon



STATUT I NDRYSHUAR I SHOQERISE UNITSYSTEM SHPK

Neni 17

**Ligji i zbatueshem dhe Zgjidhja e mosmarreshjeve**

- 17.1 Ky akt bazohet ne legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmeria dhe zbatimi i tij, duhet te kryhen ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete Statut do te zbatohen dispozitat e Ligjit per shoqerite tregtare.
- 17.2 Mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Statuti, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Tiranës.

*Ky dokument eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen angleze.*

**ORTAKET**

Smartwork Shpk.


  
Andrea Ruscica

  
Gjergji Robo

Gjergji Robo

TeamSystem S.p.A.

  
Tommaso Giovanni Cohen

  
Viktoria